

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-113/13

Prishtinë, 27 shkurt 2014

Në çështjen juridike të:

S. T.

S. T.

B.T.

Fshati Z.

Komuna e P.

Kosovë

Palët ankuese

kundër

R. J.

R.P. nr. 4.

3. S.

Paraqitësi i kërkesës/Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit EULEX, Ëillem Brouëer gjyqtar i EULEX-it dhe Sylejman Nuredini, gjyqtar, anëtarë të trupit gjykues, në ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës PCC/D/A/13/2008, të datës 30 prill 2008, lidhur më lëndën KPA23187, pas shqyrtimit të mbajtur me 27 shkurt 2014, mori këtë

AKTGJYKIM

Hedhet si e palejueshme ankesa e S. T.B. T. dhe S. T. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/13/2008, të datës 30 prill 2008, për sa i përket lëndës KPA23187.

Përmbledhja e çështjeve procedural dhe faktike:

1. Më 30 maj 2007, R. J. (këtej e tutje “paraqitësi i kërkesës” apo “pala përgjegjëse në ankesë”), si bartës i së drejtës pronësore ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) për vërtetimin e së drejtës së tij pronësore mbi ngastrën nr. 319, e identifikuar në fletën poseduese nr. 2, të lëshuar më 10 mars 2004 nga Zyra e Gjeodezisë e Republikës së Serbisë, Komuna e Podujevës, zona kadastrale Zakut, emri i vendit Belasice, e kategorizuar si pyll i klasës të dytë, me sipërfaqe prej 1 ha 13 ari, si dhe ri-posedimin dhe kompensimin për pyllin e prerë.
2. Për ta mbështetur kërkesën e tij, paraqitësi i kërkesës paraqiti në AKP kopjet e letërnjoftimit të tij dhe fletën poseduese të cekur më lartë.
3. Kërkesës i është caktuar nga AKP-ja numri i referimit të lëndës KPA23187.
4. Më 28 shkurt 2008, AKP-ja ka verifikuar fletën poseduese të lartcekur dhe gjeti se përmbajtja konfirmohej nga fleta poseduese nr. 2 e Komunës së Podujevë, zona kadastrale Zakut, zona kadastrale nr. 71712034, ngastra nr. 319, vendi Bellasicë, e lëshuar nga Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), më datën 18 janar 2008.

5. Më 8 shkurt 2008, ekipi njoftuese i AKP-së shkoi në vendin ku ndodhej ngastra e kërkuar dhe vendosi një shenjë që tregonte se prona ishte objekt i kërkesës, dhe se palët e interesuara duhej të paraqitnin përgjigjet e tyre brenda 30 ditëve. Prona (tokë komerciale pa objekte, tokë/pyll) është gjetur pa shenja të uzurpimit.
6. Pasi që askush nuk reagoi ndaj njoftimit, kërkesa u trajtua si e pakontestueshme.
7. Më 30 prill 2008, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) mori vendimin grupor KPCC/D/A/13/2008, duke vërtetuar të drejtën pronësore të paraqitësit të kërkesës mbi pronën e kërkuar, si dhe duke konfirmuar të drejtën e tij për posedimin e pronës në fjalë.
8. Vendimi i KKPK-së i është dorëzuar paraqitësit të kërkesës më 7 prill 2009.
9. Me kërkesën e datës së njëjtë, paraqitësi i kërkesës kërkoi që prona të vihet nën administrimin e AKP-së. Por kërkesa është refuzuar me vendimin e datës 7 dhjetor 2010. Vendimi iu dorëzua paraqitësit të kërkesës më 23 dhjetor 2010.
10. Më 11 mars 2013, paraqitësi i kërkesës kërkoi ri-posedimin e pronës.
11. Më 15 prill 2013, vendimi i KKPK-së në dobi të paraqitësit të kërkesës së bashku me një fletë informimi për ankesa i është dorëzuar uzurpuesit aktual të pronës i identifikuar si S.T..
12. Më 2 maj 2013, S. T., S. T. dhe B. T. (më tutje: palët ankuese) paraqitën ankesë kundër vendimit të KKPK-së KPCC/D/A/13/2008, të datës 30 prill 2008 lidhur me pronën e lartcekur. Në ankesë ata pretendojnë se ngastrën në fjalë e kishin blerë për 390 milion dinarë, të barasvlershme me shumën prej 37,000 (tridhjetë e shtat mijë) marka gjermane (DM), si blerës nga shitësi V. J. (babai i paraqitësit të kërkesës) sipas kontratës së lidhur më 27 dhjetor 1986 në prani të paraqitësit të kërkesës, babait të tij, bashkëshortes V.dhe të birit D., dhe në prani të disa personave tjerë. Shitësit i ishte paguar shuma e plotë e çmimit të dakorduar të blerjes.
13. Ata pohojnë gjithashtu se para dorëzimit të vendimit të KKPK-së ata nuk kishin qenë në dijeni se pronësia e ngastrës ishte kontestuar. Ata gjithashtu asnjëherë nuk kishin parë ndonjë shenjë njoftuese të AKP-së të vendosur në pronë, ndonëse *“kishin jetuar në pronë”* gjatë tërë kohës. I tërë dokumentacioni dhe provat lidhur me blerjen, pagesën dhe pronësinë mbi pronën ishin djegur në vitin 1999 së bashku me shtëpitë e palëve ankuese.

14. Për ta mbështetur ankesën e tyre, si provë ata dorëzuan disa deklarata individuale nga dëshmitarët që gjoja ishin të pranishëm gjatë lidhjes së kontratës së shitblerjes, të cilat vërtetojnë blerjen e pronës, pagesën e plotë të shumës së dakorduar dhe djegien e dokumentacionin në zjarr si dhe dokumentet e lëshuara nga Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim e Komunes së Podujevës të cilat vërtetojnë se shtëpitë e palëve ankuese në fshatin Zakut ishin djegur në vitin 1999.

15. Palët ankuese kërkojnë që të anulohet vendimi i ankimuar i KKPK-së dhe të refuzohet kërkesa e paraqitësit të kërkesës.

16. Ankesa i është dorëzuar paraqitësit të kërkesës më 5 gusht 2013.

17. Më datën 9 gusht 2013, pala përgjegjëse në ankesë R. J. u përgjigj në ankesë. Ai propozon që ankesa të hidhet poshtë si e papranueshme, apo të refuzohet si e pabazuar. Palët ankuese nuk kishin marrë pjesë në procedurën para AKP-së edhe pse ishin njoftuar siç duhet për kërkesën. Pasi që nuk kanë qenë palë në procedurën para AKP-së, ata nuk kanë të drejtë të paraqesin ankesë kundër vendimit të KKPK-së.

18. Ndërkaq, pala përgjegjëse në ankesë pohon se ai është pronari ligjor i tokës në fjalë, se ngastra asnjëherë nuk ka qenë objekt i shtijës as nga babai i tij, V. J., e as nga ai vetë. Çdo pretendim se toka është shitur ndonjëherë është i pavërtetë. Kjo është e qartë nga fakti se në vitin 1986 nuk ka pasur kufizime ligjore në fuqi për shitjen e tokës në Kosovë dhe rrjedhimisht bartja e pretenduar ka qenë i mundur të vërtetohet dhe regjistrohet në librat kadastral pa kurrfarë pengese. Në tokën në fjalë kurrë nuk është ndërtuar ndonjë shtëpi.

Të gjeturat e gjykatës:

19. Ankesa është e palejueshme.

20. Në pajtim me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut për zgjidhjen e kërkesave pronësore lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 (në tekstin e mëtejme Ligji nr. 03/L-079), *pala* mund të paraqes ankesë brenda (30) ditëve nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës mbi vendimin e Komisionit për kërkesën. Po ashtu, nenet 176.1 dhe 177.1 të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore parashohin se e drejta për të paraqitur ankesë i përket *palëve* të procedurës së shkallës së parë.

21. Në rastin e tanishëm, palët ankuese nuk kanë qenë palë në procedurën e shkallës së parë para KKPK-së. Për ta shpjeguar situatën, palët ankuese pohojnë se ata kanë kuptuar për kontestin lidhur me ngastrat vetën

më 15 prill 2013 kur vendimi i kontestuar i KKPK-së i është dorëzuar S. T.. Në fakt, neni 10.3 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 parasheh: *“Personi me interes ligjor në kërkesë i cili nuk ka marrë njoftimin mbi kërkesën mund të pranohet si palë kurdoqoftë gjatë procedurës.”*

22. Prandaj, e drejta e palëve ankuese për të paraqitur ankesë kundër vendimit të kontestuar varet nga fakti nëse janë njoftuar me rregull për kërkesën. Mënyra për njoftimin e një kërkesë në këtë procedurë parashihet me nenin 10.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079. Sipas kësaj dispozite, Sekretaria Ekzekutive e njofton dhe i dërgon nga një kopje të kërkesës çdo personi, përpos paditësit, i cili aktualisht ushtron apo pretendon se ka të drejtë në pronën e cila është objekt i kërkesës dhe bën përpjekje të arsyeshme për të njoftuar çdo person tjetër i cili mund të ketë ndonjë interes ligjor në këtë pronë.

23. Më 8 shkurt 2008, AKP-ja kishte vendosur shenjën e njoftimit në pronë me informatat ligjërisht të obligueshme rreth kërkesës në gjuhët shqipe, serbe dhe angleze. Kjo dokumentohet me raportin e ekipit njoftues të AKP-së, fotografive dhe hartës ajrore që tregojnë shenjën dhe koordinatat e GPS-it të lokacionit ku është instaluar. Fotografia dhe harta dëshmojnë se shenja ishte vendosur afër një rruge në një vend të hapur ku mund të shihej qartë.

24. Palët ankuese pretendojnë se kishin pronën gjatë tërë kohës. Si rrjedhojë, nuk ka ndonjë të indikacion se ata kanë mundur të mos e vërejnë shenjën dhe të mos kenë pasur dijeni për kërkesën.

25. Duke ardhur në konkludim nga të gjitha rrethanat e lartcekura, Gjykata Supreme konsideron se palët ankuese kanë pasur mundësi të jenë në dijeni për procedurën dhe ta paraqesin mbrojtjen e tyre në shkallën e parë. Pasi që ata nuk janë përgjigjur në kërkesë brenda afatit ligjor dhe rrjedhimisht nuk janë bërë palë në procedurën para KKPK-së, ata nuk lejohen të paraqesin ankesë në Gjykatën Supreme kundër vendimit të KKPK-së. Prandaj, ankesa hedhet poshtë si e palejueshme sipas nenit 13.3 (b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 (shih po ashtu nenet 196 dhe 195.1 (a) të Ligjit për Procedurën Kontestimore).

26. Gjykata konsideron se edhe po të ishte e pranueshme ankesa, ajo do të refuzohej si e pabazuar pasi që palët ankuese nuk i kanë dëshmuar të drejtat e tyre pronësore mbi pronën e kontestuar.

27. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme e Kosovës vendos sikurse në dispozitiv.

Udhëzim juridik:

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Ëllem Brouëer Gjyqtar i EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Holger Engelmann, Referent i EULEX-it